



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, nenit 4 dhe 10 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, duke vendosur sipas kërkesës 1Nr.400-37904 të datës 19.08.2020, nga Arberita Ahmeti nga Torina, Kryetari i Komunes nxjerr këtë:

**VENDIM
PËR MBËSHTETJE FINANCIARE**

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 300 € (treqind euro), Arberita Ahmetit nga fshati Torinë, sipas kërkesës të saj 1Nr.400-37904 të datës 19.08.2020, shuma e cekur i ndahet për ta mbështetur financiarisht për trajtim mjeksor të saj dhe përdorimin e barnave të caktuara nga mjeket.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2020 pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të babit të paraqitëses së kërkesës Naim Ahmeti në nr. 1501080002076795 në Raiffeisen Bank.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Arberita Ahmeti nga Torina.

1Nr. 400-37904
Lipjan, më 20.08.2020

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

